

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Lindita Kika Berisha nga Prishtina, për kundërvajtje neni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zytareve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zytare, e në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe konform nenit 198 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 09.08.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET: Procedura kundërvajtëse ndaj Lindita Kika Berisha, e lindur me 24.04.1976 në Prishtinë, tani jeton në Rr. Sejdi Kryeziu 18/8 në Prishtinë, menaxhere në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, e martuar nënë e dy fëmijëve, fakultetin e kryer, e gjendjes së mesme ekonomike për kundërvajtjen nga neni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zytareve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zytare. Procedura pezullohet konform nenit 198 par. 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet palës dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate kërkesën Nr. 01 2162/2012 me dt. 04.06.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurës Lindita Kika Berisha për kundërvajtjen nga neni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zytareve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zytare, me të cilën kërkesë i vihet në barre se në Agjencinë Kundër Korrupsionit nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë deri me dt. 31 mars 2012.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurës i cila deklaroi se nuk e pranon kundërvajtjen e cila i vihet mbi barre, duke dëshmuar se ushtron pozitën si menaxhere në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës sipas Ligjit nr. 04/L-050 nuk e obligon për ta deklaruar Pasurinë.

Në baze të dhënave nga fletëparaqitja, deklaratës së të pandehurës, deklaratës së dëshmitares Diana Pacolli, Juriste dhe e ngarkuar me punë si në Pike kontaktuese në mes Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës dhe Agjencia Kundër Korrupsionit për përpilimin e listave të zytareve të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë, ka pranur gjatë përpilimit të listave se ka bërë një gabim teknik, ku gabimisht e ka dhënë edhe emrin e Lindita Kika Berisha. Për vërtetimin e gjendjes faktike Gjyqtarja mori në pyetje Agrion Behrami, Zyrtar i në Agjencinë Kundër korrupsionit, i cili deklaroi se në veprimet si pas lista vete cila ua dërgojnë pikat kontaktuese të Institucioneve.

Pas administrativit të provave u konstatua se e pandehura në baze të kontratës së punës nuk është e obliguar të beje deklarin pasurisë, andaj u konstatua se ndaj të pandehurës nuk ka prova se ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet mbi barre.

Gjykata e Pezulloi procedurën kundërvajtëse ndaj të Lindita Kika Berisha, konform nenit 198 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet

U V E N D O S N E G J Y K A T E N K O M U N A L E P Ë R K U N D Ë R V A J T J E N Ë P R I S H T I N Ë

Nr. Regj 24124/12 me dt. 09.08.2012

Gjyqtarja

Lindita Jakupi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtror Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep Dep	DPK/DMP
Nr. llog. Broj stranica Nr. pages	01
Nr. Prot. Br. Prot Prot No	03-2941/12
Data Datum Date	02-08-2012
PRISHTINE	